

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

A l b G a r d e n

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K37513520N

NUIS/NIPT

Lagjja Skenderbeg , godine private 1 kateshe ne superstraden Lezhe - Shkoder, km 1

Adresa

Lezhë

Albania

4501

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0682020802

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

021523801

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

infoalbgarden@gmail.com

E-mail

Administratori Pjetër Trashaj

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/01/13

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355682020802

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

021523801

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-49887-11-14-2022

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit Tirane

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

300000000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje Peme dekorative per Pyllin Orbital dhe zona te ndryshme te Tiranës

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/01/16

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/01/16

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/47981/11142022

03452000-3 - Pemë,

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji me Nr. 162/2020 ?Per Prokurimin Publik?

VKM 285, dt 19.05.2021 ?Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit publik?

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/dis operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Në datën 15.11.2022 Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit ka publikuar në SPE procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-49887-11-14-2022, me objekt “Blerje pemë dekorative për pyllin orbital dhe në zona të ndryshme të Tiranës”, me fond limit 300.000.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 15.12.2022.

Pasi jemi njohur me kriteret e kualifikimit, Shoqëria “AlbGarden” sh.p.k., në datë 24.11.2022 ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor.

Në datë 30.11.2022, me anë të shkresës me nr. 2232/13 prot., autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën tonë.

Në këto kushte ankesa e paraqitur nga shoqëria jonë ka vijuar trajtimin nga KPP.

Me vendimin Nr. 1207/2022, Nr. 2625/4 prot., datë 02.12.2022, publikuar në datë 05.12.2022 KPP ka vendosur:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AlbGarden” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-49887-11-14-2022, me objekt “Blerje pemë dekorative për pyllin orbital dhe në zona të ndryshme të Tiranës”, me fond limit 300.000.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 15.12.2022, nga Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit;
2. Autoriteti Kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të KPP.

Në datë 07.12.2022 me anë të shkresës nr. 2232/17 prot., me objekt: “Njoftim për ndryshimin e dokumenteve të Tenderit” Autoriteti Kontraktor ka njoftuar për ndryshimin e dokumenteve të tenderit, duke pretenduar se ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 1207/2022, datë 02.12.2022.

Pasi kemi konstatuar disa paligjshmëri në veprimet e Autoritetit Kontraktor, lidhur me zgjatjen e afatit të hapjes së ofertave, lidhur me publikimin e shtojcës me kriteret e modifikuara vetëm në gjuhën shqipe, si dhe lidhur me pretendimin e AK se e ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 1207/2022, në datë 15.12.2022 kemi paraqitur një ankesë përpara AK, të cilën e kemi paraqitur edhe pranë KPP për dijeni.

Në datë 19.12.2022 jemi njohur nëpërmjet sistemit elektronik të Prokurimeve SPE se procedura e prokurimit është pezulluar nga Autoriteti Kontraktor.

Në datë 20.12.2022 jemi njohur nëpërmjet sistemit elektronik të Prokurimeve SPE me shtojcën e publikuar nga AK, nga ku rezulton se:

- 1) Autoriteti Kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje ankesës së paraqitur në datë 15.12.2022 nga shoqëria jonë, por duke e konsideruar si “lapsus” veprimet e tij, ka publikuar shtojcën e modifikimit të kriterëve të kualifikimit në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze;
- 2) Autoriteti Kontraktor ka shtyrë afatin e hapjes së ofertave me 7 ditë, pra nga data 20.12.2022 që ishte parashikuar të hapeshin ofertat, AK ka njoftuar se ofertat do të hapen në datë 27.12.2022;

Në datën 22.12.2022 jemi vënë në dijeni nga shkresa nr. 2806/2 e KPP, se Autoriteti Kontraktor nuk i ka dërguar KPP-së asnjë informacion lidhur me trajtimin e ankesës tonë, siç parashikohet në nenin 114 të LPP-së.

Po në datë 22.12.2022 jemi vënë në dijeni të përgjigjes që AK i ka kthyer KPP.

Në datë 28.12.2022 jemi njohur me Vendimin nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili pasi ka shqyrtuar ankesën tonë për modifikimin e kritereve të kualifikimit nga ana e Autoritetit Kontraktor DPPGJ, ka vendosur:

- 1) Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF49887-11-14-2022, me objekt “Blerje peme dekorative për pyllin orbital dhe në zona të ndryshme të Tiranës”, me fond limit 300.000.000 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 15.12.2022, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.
- 2) Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në datë 05.01.2023 jemi njohur me shtojcën e publikuar nga Autoriteti Kontraktor DPPGJ në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, nëpërmjet së cilës pretendohet se është zbatuar vendimi nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Pasi jemi njohur me njoftimin dhe shtojcën e publikuar nga Autoriteti Kontraktor, në datë 06.01.2023, kemi konstatuar se vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1298/2022 datë 27.12.2022, nuk është zbatuar siç urdhëron, por vetëm pjesërisht, duke shkelur hapur Ligjin dhe Rregullat e Prokurimit Publik. Kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara nga AK për këtë procedurë prokurimi, nuk janë modifikuar sipas arsytimit që KPP në cilësinë e organit më të lartë vendimmarrës në fushën e prokurimeve, ka vendosur.

Në nenin 118 “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik”, pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se: 2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

Referuar veprimeve të Autoritetit Kontraktor, rezulton se me moszbatimin e plotë të vendimit të KPP nr. 1298/2020, është shkelur parashikimi ligjor i përcaktuar në nenin 118 të LPP.

Në këto kushte, në datë 09.01.2023 i kemi drejtuar një kërkesë Autoritetit Kontraktor dhe për dijeni edhe KPP-së (si dhe disa Institucioneve të tjera shtetërore) me anën e së cilës kemi kërkuar: “Zbatimin me korrektësi të vendimit të KPP nr. 1298/2022 datë 27.12.2022, si dhe mbajtjen e pezulluar të procedurës së prokurimit deri në zbatimin e plotë të këtij vendimi”.

Gjithashtu, kërkesën e sipërcituar e kemi depozituar fizikisht me anë të shërbimit postar si pranë Autoritetit Kontraktor ashtu edhe pranë KPP-së.

Deri më sot, në datë 12.01.2023 Autoriteti Kontraktor nuk na ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e paraqitur në datë 09.01.2023 me objekt zbatimin e vendimit nr. 1298 të KPP-së.

Po kështu, në sistemin elektronik të prokurimeve, SPE nuk rezulton që Autoriteti Kontraktor të ketë bërë ndryshime të tjera pas datës 05.01.2023, pra praktikisht në gjykimin dhe vlerësimin tonë nuk është zbatuar plotësisht Vendimi i KPP nr. 1298/2022 datë 27.12.2022.

Gjithashtu në datë 09.01.2023 i kemi drejtuar Autoritetit Kontraktor edhe një kërkesë për sqarim me anën e së cilës kemi kërkuar që nga ana e AK të saktësohen koordinatat për gropat që duhet të hapen, pasi nga verifikimi që ne kemi kryer në terren, në rrugët ku AK kërkon të mbjellë pemët dekorative aktualisht ka shumë gropa të hapura. Për këtë pretendim ne disponojmë edhe fakte (foto dhe video) ne te gjitha rruget qe do kryhen punimet per mbjelljen e drurve dekorativ. Në këto kushte kemi kërkuar sqarimin e këtij fakti me qëllim qartësimin e operatorëve ekonomikë që janë të interesuar për paraqitjen e një oferte objektive për këtë procedurë prokurimi.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, në datë 11.01.2023 na është kthyer përgjigje për kërkesën për sqarim duke cituar dhe përmendur gjithë materialin që AK ka hartuar dhe publikuar por pa përmendur asnjë koordinatë, si dhe pa dhënë asnjë përgjigje apo arsye mbi faktin se pse ekzistojnë shumë gropa të hapura në madhësinë ekzakte qe nevojitet për mbjelljen e drurëve dekorative dhe pse këto gropa ndodhen pikërisht në rrugët që AK ka kërkuar të mbjellen drurët dekorativë në këtë procedurë prokurimi.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Duke qenë se as vendimi i KPP nr. 1298/2020 datë 27.12.2020, nuk është zbatuar i plotë, si dhe duke qenë se AK nuk na ka sqaruar lidhur me koordinatat ku kërkohen të mbillen pemët, në këto kushte, referuar nenit 97 “Afatet për paraqitjen e ankesave” të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjet?) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; brenda afatit ligjor të sipërcituar po paraqesim ankesën tonë duke parashtruar argumentet si vijon:

A) Lidhur me “zbatimin” e vendimit të KPP nga ana e Autoritetit Kontraktor, konstatojmë se ai është zbatuar pjesërisht, vetëm pjesa i përket gjuhës së dokumenteve të tenderit (shqip + anglisht) dhe afatit të shtyrjes së ofertave (10 ditë nga data e modifikimit), ndërkohë që konstatojmë se nuk është zbatuar vendimi i KPP lidhur me modifikimin e kritereve të veçanta të kualifikimit.

Më konkretisht argumentojmë se:

1) Kriteri i veçantë i kërkuar nga AK në pikën 2.3.11 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit në datë 07.12.2022 është modifikuar si vijon: “Operatori ekonomik duhet të disponojë (në pronësi ose me qira) një sipërfaqe toke prej minimumi 14,000 (katërmëdhjetë mijë) m² për magazinimin e pemëve (drurëve) në territorin e Bashkisë Tiranë, kjo sipërfaqe toke do t’i lihet në përdorim pa të drejtë pagese Autoritetit Kontraktor DPPGJ për 1 vit nga momenti i lidhjes së kontratës. Te paraqiten dokumentet e vlefshme që tregojnë pronësinë e ambientit

(sipërfaqes së tokës) ose kontratën e qirasë. Sipërfaqja e tokës duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme nga mjetet e tonazhit të rëndë me anë të të cilave do të kryhet dhe zhvendosja e pemëve nga sipërfaqe e tokës në zonën e mbjelljeve në qytet. Ambienti do të shërbejë për vendosjen e mallit i shoqëruar me vazo/bukë dhe referuar kërkesave të specifikimeve teknike dhe preventivave. Kjo pikë përmbushet nëpërmjet plotësimit të formularit të vetë-deklarimit sipas shtojcës përkatëse.

Sqarojmë se kërkesa për kohëzgjatja 1 (një) vjeçare i referohet VKB Nr. 100 datë 19.10.2022, e cila përcakton afatin e angazhimeve buxhetore afat mesme 2(dy) vite buxhetore sipas ndarjes përkatëse në VKB, periudhë e cila përkon me sezonin e mbjelljeve përgjatë vitit 2022-2023 (periudha e zbatimit të kontratës). Kjo sipërfaqe toke do t'i shërbejë AK për magazinimin e gjithë mallit të furnizuar. Kjo sipërfaqe toke duhet të jetë e niveluar, duhet të ketë kontratë me OSHEE dhe UKT. Sipërfaqja e tokës duhet të jetë e pozicionuar 8-10 km nga Unaza e Vogël e Tiranës, kjo për të lehtësuar proceset të natyrës logjistike të transportit të drurëve dhe për të përmbajtur kostot operative nga ana e mjeteve të rënda të transportit të DPPGJ me anë të të cilave do të kryhet transporti i drurëve nga sipërfaqja e tokës deri në vendin e mbjelljes (vendosjes) së pemëve.”.

KPP në vendimin nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 gjatë gjykimit të këtij kriteri të modifikuar ka gjykuar se: kërkesa e autoritetit kontraktor për një sipërfaqe minimumi 14,000 m2 si dhe që objekti të jetë 8-10 km nga Unaza e Vogël e Tiranës është një kërkesë e ekzagjeruar, jo në përputhje me objektin dhe natyrën e objektit të prokurimit e cila kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk argumenton teknikisht përse sipërfaqja e nevojshme duhet të jetë 14.000 m2 apo distanca 8-10 km nga Unaza e Vogël e Tiranës. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet ta ulë ndjeshëm kërkesën në lidhje me sipërfaqen totale, duke i krijuar mundësinë operatorëve ekonomikë të disponojnë një sipërfaqe optimale të ambientit për magazinimin e bimëve, e cila përmbush nevojën e përshkruar edhe në dokumentet e tenderit, duke zgjeruar kështu pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kërkesën për vendndodhjen e këtij objekti, duke e hequr atë ose duke e rishikuar në mënyrë që të mos ketë kufizime të cilat cenojnë pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë, të cilët kanë interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Akoma më tej, për sa i përket kërkesës së operatorit ekonomik ankimes, [...] lidhur me këtë kërkesë të autoritetit kontraktor, kemi kërkuar sqarim/informacion mbi arsyet se pse sipërfaqja e tokës/ambientit duhet të ketë kontratë me OSHEE dhe UKT. E thënë shkurt pse duhet të ketë ambientin për magazinim e pemëve (drurëve) ujë dhe drita?? [...] duke qenë se nuk kemi marrë përgjigje nga AK për një kërkesë kaq bazike për sqarim, kërkojmë që ky kriter kualifikimi të qartësohet duke dhënë argumente mbi proceset teknike që kërkon të realizojë autoriteti kontraktor për pasjen e ambientit për magazinimin e pemëve (drurëve) me ujë e drita.”, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të sqarojë operatorin ekonomik ankimes, me qëllim që çdo operator ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, të jetë i qartë në lidhje me kriteret dhe mënyrën e plotësimit të tyre. Gjithashtu, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme është e paqartë për sa kohë nuk krijohet lidhja midis objektit kryesor të procedurës së prokurimit dhe qëllimit të kësaj kërkesë nga ana e autoritetit kontraktor.

Pasi ka hartuar Shtojcën e modifikimit të dst-ve në datë 05.01.2023 AK e ka “modifikuar” këtë kriter duke kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të disponojë (në pronësi ose me qira) një sipërfaqe toke prej minimumi 13,000 (trembëdhjetë mijë) m2 për magazinimin e pemëve (drurëve) në territorin e Bashkisë Tiranë. Kjo sipërfaqe toke do t'i lihet në përdorim pa të drejtë pagese Autoritetit Kontraktor DPPGJ nga data e lidhjes së kontratës deri më 31.12.2023. Për plotësimin e këtij kriteri OE , duhet të paraqesë dokumentet e vlefshme që tregojnë pronësinë e ambientit (sipërfaqes së tokës) ose kontratën e qirasë. Sipërfaqja e tokës duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme nga mjetet e tonazhit të rëndë me anë të të cilave do të kryhet dhe zhvendosja e

pemëve nga sipërfaqja e tokës në zonën e mbjelljeve në qytet. Duhet të jetë e niveluar, duhet të ketë kontratë me OSHEE dhe UKT. Ambienti do të shërbejë për vendosjen e mallit i shoqëruar me vazo/bukë dhe referuar kërkesave të specifikimeve teknike dhe preventivave.

Shënim: Ky kriter (2.3.11) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetë deklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor. AK, sqaron se kërkesa për kohëzgjatje deri me 31.12.2023 i referohet VKB Nr. 100 datë 19.10.2022, e cila përcakton afatin e angazhimeve buxhetore afat mesme sipas ndarjes përkatëse në VKB, periudhë e cila përkon me sezonin e mbjelljeve përgjatë vitit 2023 (periudha e zbatimit të kontratës). Kjo sipërfaqe toke do t'i shërbejë AK për magazinimin e gjithë mallit të furnizuar. Përsa i përket kërkesës që sipërfaqja e tokës të jetë e niveluar dhe të ketë kontratë me UKT dhe OSHEE, kjo ka të bëjë me faktin se kemi të bëjmë me një sipërfaqe magazinimi që do të kryhen procese pune të përditshme nga stafi i AK dhe do të jetë i aksesueshëm për hyrje-daljen e mjeteve dhe personave të cilët do të operojnë në zbatimin e mansonëve të punës dhe gjithashtu do të jetë i stacionuar në vendndodhjen e magazinës. Gjithashtu në respekt të kushteve minimale të punës si dhe në respektim të Kodit të Punës dhe Manualeve teknike të punës, duhet të ketë ndriçim dhe aksesueshmëri dhe lehtësi në realizimin e proceseve të mirëmbajtjes dhe kujdesit ndaj bimësisë dekorative si dhe plotësimit me kushte higjieno - sanitare të stafit është vendosur kërkesa që sipërfaqja e magazinimit të ketë kontratë me OSHEE dhe UKT.

Lidhur me kërkesën që sipërfaqja e tokës duhet të jetë e pozicionuar brenda territorit të Bashkisë Tiranës, kjo për të lehtësuar proceset e natyrës logjistike të transportit të drurëve dhe për të përmbajtur kostot operative nga ana e mjeteve të rënda të transportit të DPPGJ me anë të të cilave do të kryhet transporti i drurëve nga sipërfaqja e tokës deri në vendin e mbjelljes (vendosjes) së pemëve.

Ky kriter i vjen në ndihmë AK duke i dhënë siguri për realizimin e kësaj kontrate. Për shkak se malli është furnizimi dhe vendosja do të kryhet me mjetet drejtorisë tonë, dhe gjithashtu duke qenë se furnizimi ka një numër të konsiderueshëm mallrash (drurë dekorativ), kostot logjistike të transportit nga magazina e OE, do të rriteshin ndjeshëm për distanca të largëta duke rrezikuar realizimi i kontratës.

Ne kuptimin e mundësisë buxhetore të institucionit, të parashikimeve përkatëse, qartësisht çdo Km i përshkruar llogaritet në shpenzimet e institucionit për zërin shpenzime transporti, dhe kjo është parashikuar dhe përlllogaritur sipas mundësitë buxhetore për vitin 2023. Kjo lidhet drejtë për drejtë me vijimësinë e punës për DPPGJ, duke krijuar kështu mundësinë e përmbushjes së afateve kohore dhe cilësinë e mbjelljes së pemëve të parashikuara për t'u mbjellë brenda sezonit të mbjelljes.

Nga shtojca e publikuar nga AK në datë 05.01.2023 rezulton se nuk është zbatuar vendimi i KPP për këtë kriter pasi: nga ana e AK është modifikuar në mënyrë të moderuar vetëm sipërfaqja e tokës ku do të magazinohen bimët pra nga 14.000 m² në 13.000 m². Ndërkohë që vendimi nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 i KPP lidhur me sip. që kërkohet shprehet se: "autoriteti kontraktor duhet ta ulë ndjeshëm kërkesën në lidhje me sipërfaqen totale, duke i krijuar mundësinë operatorëve ekonomikë të disponojnë një sipërfaqe optimale të ambientit për magazinimin e bimëve. A është sipërfaqja e re nga 14000 m² në 13000 m² një ulje e ndjeshme siç përcakton KPP në mënyrë që të hapet gara dhe të rritet konkurrenca ??? Qartazi rezulton se JO. Pra vendimi i KPP nuk është zbatuar nga AK lidhur me këtë pikë. Gjithashtu, KPP në vendimin nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 shprehet se: autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kërkesën për vendndodhjen e këtij objekti, duke e hequr atë ose duke e rishikuar në mënyrë që të mos ketë kufizime të cilat cenojnë pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë, të cilët kanë interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Lidhur me këtë arsyetim të KPP rezulton se AK nuk e ka zbatuar, pasi në shtojcën e publikuar AK përsëri ka kërkuar që ambienti ku do të magazinohen bimët dekorative të jetë në

territorin e Bashkisë Tiranë, duke diskriminuar të gjithë operatorët ekonomikë të tjerë të cilët nuk disponojnë ambient magazinimi në Bashkinë Tiranë por mund ta disponojnë në çdo qytet të Shqipërisë dhe ndërkohë marrin përsipër furnizimin e mallit në kohë, me cilësi, në vendin e kërkuar dhe me çmim shumë preferencial për AK. Autoriteti Kontraktor është kontradiktor në argumentet që jep pasi kur i intereson deklaron se kjo kontratë është një kontratë e përzier dhe kur nuk i intereson deklaron se kjo kontratë është kontratë furnizimi. Dukshëm me këto veprime po rezulton se ky tender është i paracaktuar dhe të gjithë operatorët e tjerë “përveç fituesit” do të pengohen të konkurrojnë. Po kështu AK ka dështuar të zbatojë vendimin e KPP lidhur me arsyetimin e kërimit të kontratave të OSHEE dhe UKT për ambientin e magazinimit. Arsyetimi i AK lidhur me këtë kërkesë nuk ka asnjë lidhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe ka si synim të vetëm përjashtimin e sa më shumë operatorëve ekonomikë nga kjo garë. Ligji përcakton se e rëndësishme për AK është të krijojë bindjen se operatorët ekonomikë ofertues kanë kapacitetet teknike e financiare të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës dhe jo të krijojnë pengesa e kritere artificiale të cilat kanë si qëllim të vetëm uljen e konkurrencës.

Në këto kushte, pretendojmë se vendimi nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 i KPP nuk është zbatuar dhe për pasojë Autoriteti Kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter kualifikimi në përputhje me arsyetimin e vendimit të KPP. Gjithashtu, AK nuk duhet të lejohet të vijojë me zhvillimin e procedurës së prokurimit deri në modifikimin e këtij kriteri.

2) Kriteri i veçantë i kërkuar nga AK në pikën 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit në datë 07.12.2022 është modifikuar si vijon: “Një punësim mesatar i të paktën 139 personave, për periudhën 3 muajt e fundit (Gusht 2022-Tetor 2022) të vërtetuar me:

i. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Gusht 2022-Tetor 2022.

ii. List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Gusht 2022-Tetor 2022

Kërkesa për numrin mesatar të punonjësve lidhet ngushtë me natyrën e kontratës e cila është një kontratë e përzier, përmasat dhe kohën e zbatimit të saj. Gjithashtu ky numër lidhet ngushtë dhe me numrin e parashikuar të makinerive, pajisjet e asetet e tjera fizike, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.”

KPP gjatë gjykimit të këtij kriteri ka gjykuar se: “kërkesa e autoritetit kontraktor për 139 punonjës është një kërkesë e ekzagjeruar, e cila tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës, pasi një numër i tillë punonjësish është tërësisht jo proporcional me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve, por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës, volumi i saj si dhe kohëzgjatja. Konkretisht, autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk ka paraqitur një argument teknik dhe analizë të detajuar në lidhje me kërkesën për disponimin e një numri kaq të lartë punonjësish. Konkretisht në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit është paraqitur një analizë në lidhje me kërkesën e mësipërme, ku për çdo mjet është kërkuar një shofer dhe një numër punonjësish i cili varion nga 2-4 punonjës për secilin mjet, por në asnjë moment nuk është paraqitur një analizë teknike për të argumentuar këtë kërkesë. Gjithashtu, në analizën e paraqitur nga autoriteti kontraktor, është marrë i mirëqenë fakti, se të gjitha mjetet do të punojnë në të njëjtën kohë, por pa e argumentuar këtë. Akoma me tej, referuar Formularit të sasisë dhe grafikut të lëvrimit, specifikimeve teknike, si dhe termave të referencës në dokumentet e tenderit vërehet, se ky i fundit kërkon të realizojë furnizimin me 24623 drurë dhe shkurre dekorative, për një afat 15 ditor nga data e nënshkrimit të kontratës, ndërsa një pjesë e drurëve (përkatësisht 1058 drurë dekorativ) do të furnizohen dhe vendosen brenda një afati 15 ditor referuar preventivave përkatës të

furnizim-vendosjes. Pra, gjithsej për një periudhë 15 ditore do të mbillen 1058 drurë dekorativ. Gjithashtu, duke qenë se autoriteti kontraktor, ka parashikuar disponimin e një numri të konsiderueshëm mjetesh, do të thotë që një pjesë e procesit të mbjelljes do të kryhet me anë të mjeteve, fakt ky i cili ndikon në lehtësimin dhe uljen e proceseve të punës që duhet të kryhen me krah nga fuqia punëtore.

Në këtë kuptim Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë qartësisht dhe të ulë ndjeshëm kërkesën e mësipërme duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me volumin e furnizimeve të nevojshme, si dhe numrin e drurëve që do të mbillen, sipas afatit të caktuar, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të Ligjit për Prokurimin Publik. Autoriteti kontraktor, në përlllogaritjen e mësipërme duhet të mbajë në konsideratë kërkesat në lidhje me numrin e inxhinierëve të kërkuar, stafin teknik (teknik mekanik, hidraulik, elektrikist, auto makinist, ekskavator, pllakashtrues, etj), si dhe në përputhje me mjetet e kërkuara, sasinë e furnizimeve, si dhe numrin e pemëve që kërkohen për mbjellje brenda një periudhe të caktuar prej 15 ditësh”.

Pasi ka hartuar Shtojcën e modifikimit të dst-ve në datë 05.01.2023 AK e ka “modifikuar” këtë kriter duke kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 124 personave, për periudhën (Shtator 2022-Nëntor 2022) të vërtetuar me dokumentacion si vijon:

- i. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Shtator 2022-Nëntor 2022.
- ii. List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2022-Nëntor 2022

Shënim: Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisht dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetë deklarimit, sipas shtojcës 8, të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

AK ri sqaron se kriteri lidhur me numrin mesatar të fuqisë punëtore është vendosur në zbatim të natyrës e përmasave të kontratës dhe afatit të zbatimit të saj, gjithsesi bazuar në vendimmarrjen tuaj e ka rishikuar këtë kërkesë duke e uluar atë në 124.

Përlllogaritja është kryer bazuar natyrës dhe përmasave të kontratës, afatit të zbatimit të saj si dhe në respekt të Kodit të Punës, manualeve të ndërtimit të vitit 2015.

Fuqia punëtore është rishikuar në 124 punonjës në total sipas kategorive të ndryshme referuar tabelës së poshtë-shënuar. Mungesa e këtij stafi potencialisht mund të çojë në dështimin e kontratës së furnizimit dhe furnizim-vendosjes, ose në rastin më pak të keq do të rezultojë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe furnizimin e mallit me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor teknik është minimal dhe është përcaktuar në raport të ngushtë me natyrën specifike të mallit objekt kontrate.

Gjithashtu, në shtojcën e publikuar, rezulton se Autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë analizë të proceseve të punës apo argumentim se pse kërkohet ky numër punonjësish, por bie në sy fakti se për të mbjellë 1058 pemë dekorative për 15 ditë kërkohen 40 shoferë dhe 84 punonjës për të gjithë kohëzgjatjen e Kontratës.

Nga shtojca e publikuar nga AK në datë 05.01.2023 rezulton se nuk është zbatuar vendimi i KPP nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 dhe konkretisht:

KPP ka gjykuar se: kërkesa e autoritetit kontraktor për 139 punonjës është një kërkesë e ekzagjeruar, e cila tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës, pasi një numër i tillë punonjësish është tërësisht jo proporcional me objektin e prokurimit. AK ka modifikuar kriterin duke kërkuar 124 punonjës nga të cilët as më pak dhe as më shumë por 40 shoferë dhe 84 punonjës, duke mos

paraqitur asnjë argument lidhur me proceset e punës që do të kryejnë këta punonjës, numër punonjësish i ekzagjeruar dhe i kërkuar në kundërshtim të hapur me natyrën dhe përmasat e kontratës.

KPP ka gjykuar se: autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk ka paraqitur një argument teknik dhe analizë të detajuar në lidhje me kërkesën për disponimin e një numri kaq të lartë punonjësish. Edhe pse AK e ka modifikuar këtë kriter në asnjë rrethanë nuk e ka arsyetuar apo argumentuar me procesin konkret të punës.

KPP ka kërkuar nga AK të qartësohet nëse të gjithë këta punonjës do të punojnë në të njëjtën kohë apo jo. Në fakt edhe ky arsyetim i KPP nuk është sqaruar.

Siç e kemi sqaruar edhe në ankesën e dytë të paraqitur pranë AK dhe KPP, ju bëjmë me dije se ne kemi kryer një analizë të detajuar lidhur me proceset dhe numrin e nevojshëm të punëtorëve që nevojiten për furnizim vendosje të 1058 pemëve dekorative për 15 ditë. Nga analiza që kemi kryer bazuar në grafikun e punimeve të publikuar nga AK, duke marrë për bazë ditën kur do të jetë sasia maksimale e drurëve që duhet të mbillen (165 drurë dekorativë), rezulton se numri maksimal i punonjësve për realizimin e kësaj pjese të kontratës duhet të jetë jo më shumë se 80 punonjës. Gjithashtu kemi paraqitur edhe procesin konkret që duhet të kryejë çdo punonjës.

Në këto kushte, pretendojmë se vendimi nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 i KPP nuk është zbatuar dhe për pasojë Autoriteti Kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter kualifikimi në përputhje me arsyetimin e vendimit të KPP. Gjithashtu, AK nuk duhet të lejohet të vijojë me zhvillimin e procedurës së prokurimit deri në modifikimin e këtij kriteri.

3) Autoriteti Kontraktor nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me kërkesën tonë për sqarim për kërkesën e dst-ve: “të gjitha pemët duhet të jenë në përputhje me Ligjet dhe rregulloret e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Drurët (pemët) duhet të jenë të shëndetshme, pa sëmundje apo problematika të tjera”. Risjellim në vëmendjen tuaj se mbi këtë kërkesë të DST-ve kemi kërkuar sqarim lidhur me certifikatën që kërkohet nga AK. Autoriteti Kontraktor referuar edhe kuadrit ligjor për bimësinë dhe konkretisht: Ligjit Nr.10416, datë 07.04.2011 “Për Materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” dhe VKM nr. 523, datë 13.07.2016 “Për përcaktimin e Kriteve të Tregtimit e Certifikimit të Materialeve të shumëzimit dhe të Fidanëve të bimëve Zbukuruese”.

Referuar kërkesës tonë për sqarim, KPP ka vlerësuar se: “AK duhet të jape? sqarimet përkatëse lidhur me paqartësitë e shoqërisë “Alb Garden” sh.p.k., dhe këto sqarime duhet të publikohen edhe në SPE, në përputhje me legjislacionin në fuqi si më sipërcituar.”

AK jo vetëm që nuk ka dhënë sqarim, lidhur me këtë kërkesë ligjore, por në mënyrë shpërfillëse rezulton se nuk e ka zbatuar vendimin e KPP lidhur me këtë fakt. Sjellim në vëmendjen tuaj dhe të KPP se pikërisht këto certifikata janë dokumentet të cilat i garantojnë realizimin me sukses apo dështimin e kontratës së furnizimit që kërkohet.

Në vlerësimin tonë, ky mosveprim i AK kryhet qëllimisht për të favorizuar shoqëri të cilat nuk kanë lidhje me objektin e procedurës së prokurimit në fushën e veprimtarisë të prodhimit/tregëtimit të drurëve dekorativë, sipas kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë.

Në këto kushte, pretendojmë se vendimi nr. 1298/2022 datë 27.12.2022 i KPP nuk është zbatuar dhe për pasojë Autoriteti Kontraktor duhet të japë sqarimet përkatëse që nevojiten për OE, sipas edhe arsyetimit të vendimit të KPP-së. Gjithashtu, AK nuk duhet të lejohet të vijojë me zhvillimin e procedurës së prokurimit deri në dhënien e sqarimeve përkatëse.

B) Gjithashtu, me anë të kësaj ankese ne pretendojmë se AK duhet të japë sqarime konkrete lidhur me gjitha koordinatat përkatëse në të gjitha rrugët dhe adresat ku do të mbillen

drurët dekorativë.

Pasi jemi njohur me kriteret e kualifikimit, termat e referencës, grafikun e punimeve, preventivat dhe specifikimet teknike të publikuara për këtë procedurë prokurimi, referuar nenit 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” pika 1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me anë të një kërkesë drejtuar AK, në datë 09.01.2023 (procedura ishte parashikuar të hapet në datë 16.01.2023) i jemi drejtuar AK me një kërkesë për sqarim me objekt saktësimin e koordinatave përkatëse në të gjitha rrugët dhe adresat ku do të mbillen drurët dekorativë.

I jemi drejtuar AK me këtë kërkesë, pasi nga verifikimi që ne kemi kryer në terren na ka rezultuar se në të gjitha rrugët që kërkohet nga AK të mbillen drurët dekorativë ka shumë gropa të hapura të cilat kanë përmasat dhe natyrën e gropave ku mbillen pemë. Këtë fakt ne e provojmë me foto dhe video, të cilat po i paraqesim bashkëngjitur kësaj ankese sipas rrugeve. Në këto kushte, me qëllim sqarimin e operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë garë, kemi kërkuar sqarim nga AK për koordinatat se ku duhet të hapen gropat në rrugët e kërkuara.

Ne kemi dyshime të forta se gropat e hapura tashmë në rrugët e përcaktuara nga AK janë pikërisht gropat e kërkuara për tu “hapur” nga operatori ekonomik fitues, e nëse do të ndodhemi përballë këtij fakti, atëherë ne ndodhemi përpara një veprë penale të nderuar zyrtarë të Autoritetit Kontraktor.

Përse AK ka kërkuar kriteret për mjete, makineri, liçensa e punëtorë të kualifikuar në fushën e ndërtimit, nëse gropat ku do të mbillen drurët dekorative qenkan të hapura ?? Këto përgjigje të gjithë zyrtarët e Autoritetit Kontraktor, duke filluar nga Titullari i DPPGJ (por edhe personat jo zyrtarë të lidhur me ta) kanë mundësi t’i japin përballë Organeve Ligjzbatuese të Shetit Shqiptar.

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj të Autoriteti Kontraktor,

Siç e kemi bërë me dije që në publikimin e kësaj procedure prokurimi, qartazi rezulton se AK po mundohet që me veprime e procedura e tashmë edhe me veprime konkrete në kundërshtim të hapur me Ligjin dhe Rregullat e Prokurimit Publik, të kufizojë dhe shmangë në maksimum konkurrencën në këtë procedurë.

Ju garantojmë se jo vetëm që nuk dekurajohemi nga veprimet tuaja, por kemi evidentuar çdo fakt dhe veprim të paligjshëm, që nga publikimi i procedurës përfshirë edhe foto e video të gropave të hapura dhe do të kemi në konsideratë çdo veprim të paligjshëm deri në përfundim të realizimit me apo pa sukses të kësaj kontrate. Çfarëdo lloj paligjshmërie e evidentuar do të depozitohet në organet Ligj zbatuese.

Sa mësipër, me anë të kësaj kërkesë kërkojmë zbatimin me korrektësi të vendimit të KPP nr. 1298/2022 datë 27.12.2022, si dhe mbajtjen e pezulluar të procedurës së prokurimit deri në zbatimin e plotë të këtij vendimi.

Me respekt,

Shoqëria “AlbGarden” sh.p.k.

Administratori

Pjetër Trashaj

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

021523801

E-mail:

infoalbgarden@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Pjetër Trashaj